



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 3
Prishtinë, më 24.10. 2017, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Haxhi Shala, kryetar, Rexhep Selimi, zëvendëskryetar i parë, Zoran Mosiloviq, zëvendëskryetar i dytë, Xhelal Sveçla, Drita Millaku, Ismet Beqiri, Fadil Beka, Fatmir Xhelili, Blerim Kuçi dhe Bahrim Shabani, anëtarë.

Mungoi: Ramiz Kelmendi.

Përfaqësuesi i Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës: Rustem Berisha, ministër i FSK-së.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Luanda Domi-DCAF, Blend Zyrapi-KIPRED, Diedon Nixha-KIPRED, Arife Muji- QKSS, Remzije Zeqiraj -Ministria e FSK-së, Liridon Gashi-Ministria e FSK-së, Njomza Arifi, praktikante, Gramoz Paçarada-KDI dhe Artan Murati-KDI.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Nur Çeku dhe Zarë Aliu.

Mbledhjen e kryesoi, Haxhi Shala, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtura më 17.10.2017;
3. Informim nga ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, z. Rustem Berisha lidhur me prioritetet dhe sfidat e kësaj ministrie;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së komisionit për vitin 2017;
5. Të ndryshme.

Kryetari i komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtura më 17.10.2017

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Informim nga Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, z. Rustem Berisha, lidhur me prioritetet dhe sfidat e kësaj ministrie

Kryetari fillimisht uroi ministrin për detyrën e re dhe e njoftoi se qëllimi i kësaj takimi është që ministri të njoftojë komisionin lidhur me objektivat dhe prioritetet e ministrisë. Fjalën ia kaloi ministrit të FSK-së.

Rustem Berisha, ministër i Ministrisë së FSK-së, fillimisht theksoi që përgjatë këtyre gjashtë javëve që ka marrë këtë detyrë, është parë se janë kryer punë të mëdha në këtë ministri. Tutje theksoi që është i fokusuar në vendosjen e politikave strategjike, që FSK-ja të mirëmbaj kapacitetet e saj. Ministria e FSK-së dhe FSK-ja ka përcaktuar prioritetet dhe prioriteti kryesor është edukimi dhe zhvillimi profesional i burimeve njerëzore brenda FSK-së dhe thellimi i bashkëpunimit me vendet e rajonit, integrimi i komuniteteve jo shumicë dhe me theks komunitetin serb, kjo pasi qëllim është integrimi i këtij komuniteti. Aktualisht janë 103 pjesëtarë të komunitetit serb që janë pjesë e FSK-së dhe për ta janë organizuar, kurse për gjuhën shqipe dhe serbe, kjo me qëllim të eliminimit të barrierave të komunikimit.

Objektiv tjetër i rëndësishëm është thellimi i bashkëpunimit rajonal dhe janë duke u bërë përpjekje për avancim të këtij aspekti, ku theksoi takimin radhës në nivel ministror “Karta e Adriatikut A5” ku Kosova është në rolin e vëzhguesit, duke shpresuar që shpejt të jenë anëtarë me të drejta të plota. Gjithashtu theksoi se është duke u punuar për t’u thelluar bashkëpunimi edhe me NATO-n. Duke qenë se janë para vendimit politik, sa i përket transformimit të FSK-së në Forcë të Armatosura, theksoi se janë duke punuar për avancimin për të kompensuar periudhën e humbur, duke marrë parasysh që transformimi është dashur të ndodhë më 2014 sipas Analizës së Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë.

Gjithashtu njoftoi që FSK-ja ka ngritur një Komision që ka për qëllim modernizimin e FSK-së përgjatë procesit të përgatitjes duke shtuar që është e nevojshme koordinimi me institucionet vendore dhe ndërkombëtare si dhe komunitetin serb.

Ndërsa sa i përket gjendjes faktike, theksoi që është formuar Komuniteti për Auditim të Brendshëm që udhëhiqet nga zëvendësministri, kjo ka për qëllim për të parë gjendjen faktike dhe për të parë gabimet nëse ka dhe për të nxjerrë mësimet.

Rexhep Selimi për qasjen e opozitës theksoi se ka qenë për bashkuese për temat e rëndësishme shtetërore, siç është çështja e ushtrisë dhe themelimin e Forcave të Armatosura të Kosovës. Duke qenë se rishikimi i buxhetit është në procedurë, kërkoi që të bëhet një qasje e duhur sa i përket planifikimeve buxhetore, duke shtuar se për çështjen e ushtrisë do të jenë krah për krah Duke iu referuar raportit të progresit për Kosovën për vitin e kaluar, theksoi që ka pasur vërejtje lidhu me atë se si ka ushtuar mbikëqyrjen komisioni ndaj FSK-së, duke shtuar se mbikëqyrja ndaj Ministrisë së FSK-së, do të vazhdoj, duke uruar që fokusi i ministrisë të jetë në tema kryesore në ngritjen e kapaciteteve të FSK-së.

Zoran Mojsilović përshëndeti ministrin duke theksuar që shikon një vazhdimësi, duke theksuar që edhe pse vjen nga pjesa veriore e vendit nuk është i njohur me programet që u folën, lidhur me programet e bëra nga Ministria e FSK-së lidhur me përafrimin e komunitetit serb. Tutje shtroi pyetjen; A ka ndonjë raport për punë e deritanishme në Ministrinë e FSK-së, me qëllim të përafrimit të komunitetit serb?

Ndërsa sa i përket integritetit të komunitetit serb me theks veriu e Kosovës, gjë e cila u theksua edhe nga ministri, tha se kjo çështje është politike dhe si deputet me mandat të parë nuk mund të thotë më shumë për këtë çështje, por do të gjendet një zgjidhje e përbashkët, duke shpresuar që bashkërisht do të gjendet një zgjidhje e pranueshme.

Fatmir Xhelili vlerësoi kontributin e deritanishëm të ministrit, duke theksuar që kontributi dhe përvoja e tij do të reflektohet në ngritjen profesionale të FSK-së. Tutje shtroi disa çështja sa i përket aspektit të zhvillimit të FSK-së. A ka ndonjë vlerësim krahasues mes FSK-së dhe forcave të sigurisë të rajonit, apo ky vlerësim bëhet në bazë të standardeve evropiane dhe të NATO-s? A është paraparë për vitin e ardhshëm ushtrim fushor në nivel vendi në fushën e menaxhimit të emergjencave në bashkëveprim me segmentet e tjera të sigurisë dhe a është kërkuar buxhet për këtë çështje? A është paraparë edukimi dhe trajnimi i njësive të FSK-së, para fazës së transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura, apo jeni në pritje të vendimit politik për këtë çështje?

Drita Millaku fillimisht uroi ministrin për punën e tij dhe më pas shtroi pyetjet si vijon; A janë përmbushur standardet për transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura? Sa është numri i pjesëtarëve të FSK-së, dhe a është ky numër i mjaftueshëm për transformimin e FSK-së? A i përmbush kërkesat FSK-ja për t'u transformuar në Forcë të Armatosur me armatimin që ka? Nëse nuk i plotëson nevojat armatimi aktual, a është planifikuar në buxhet diçka e tillë?

Xhelal Sveçla fillimisht e përshëndeti ministrin dhe shtroi pyetje sa i përket procesit të rishikimit të buxhetit, sa reflekton qëllimin tonë të përbashkët për transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura? Cilat janë kërkesat dhe argumentet e Ministrisë së FSK-së, që si deputetë të konstatojmë që ky rishikim është i vlefshëm?

Bahrim Shabani e përshëndeti ministrin dhe parashtrori disa pyetje. Duke iu referuar fjalës së ministrit për multietnicitetin në Forcat e Sigurisë të Kosovës, si dhe për komunitetin serb që janë 103 pjesëtarë. Sa pjesëtarë të komuniteteve të tjera janë pjesëtarë të komuniteteve të tjera, veçanërisht të komunitetit boshnjak? Pasi në qytetin e Prizrenit jetojnë shtatëmbëdhjetë mijë boshnjakë, duke shtuar që sipas informacionit që ka në Ministrinë e FSK-së janë vetëm tre ose katër pjesëtarë të komunitetit boshnjak.

Rrustem Berisha, ministër i Ministrisë së FSK-së, lidhur me pyetjet e ngritura, theksoi që FSK-ja në bazë të mandatit të saj e ka përmbushur atë dhe ka arritur kapacitete operacione të parapara me mandatin aktual, FSK-ja është e gatshme për transformim që nga viti 2014, proces që nuk ka ndodhur për arsye politike, por që gjatë kësaj kohe është shfrytëzuar për avancimin e kapaciteteve operacionale për misionin e ri.

Ndërsa sa i përket pajisjeve të armatimit, theksoi se janë të planifikuara mirë edhe nga ekspertët vendorë dhe ndërkombëtarë dhe është pjesë e realizuar. Ndërsa sa i përket rritjes së kapaciteteve theksoi që, pas marrjes së vendimit politik është një procedure e paraparë që në mënyrë graduale të bëhet ngritja e kapaciteteve, ndërsa në Analizën e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë, është paraparë periudha dhjetë vjeçare. Ndërsa sa i përket standardeve të FSK-së, theksoi që edhe nga ekspertët e NATO-s është vlerësuar që të gjitha të arriturat janë të bazuara në standardet e NATO-s, ndërsa sa i përket çështje së komuniteteve në kuadër të FSK-së, theksoi që ka përshtypjen që shumica e deputetëve të komunitetit serb, nuk janë mjaftueshëm të njoftuar rreth të arriturave të FSK-së, projekteve për komunitetin serb.

Për këtë arsye, theksoi se është planifikuar një aktivitet nga ana e Ministrisë së FSK-së, ku do të ftohen përfaqësuesit e komunitetit serb, për të parë nga afër aktivitetet dhe projektet që janë në mbështetje të këtij komuniteti, për të identifikuar shqetësimet e këtij komuniteti. Parimisht është thënë nga përfaqësuesit e këtij komuniteti që do të pranojnë të vijnë në këtë aktivitet dhe pritet që pas përfundimit të zgjedhjeve lokale do të ndodhë ky aktivitet.

Ndërsa sa i përket ushtrimeve fushore, edukimeve, trajnimeve, theksoi se në vazhdimësi janë duke bërë aktivitete të tilla dhe janë në bashkëpunim me faktorin ndërkombëtar. Ndërsa duke iu referuar letrës së Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s z. Stoltenberg, është parë që NATO ka marrë vendim për avancimin e çështjes dhe është quajtur “ndërveprueshmëri e shtuar” ku në kuadër të kësaj janë bërë hapa pozitiv nga ana e FSK-së, siç janë stërvitjet e përbashkëta me KFOR-in, gjithashtu është arritur që të hartohet edhe plani i integritetit që është shumë i rëndësishëm.

Më tutje theksoi që e vlerëson që FSK-ja ka arritur kapacitetet për misionin që ka, dhe me këtë mision mund të kontribuojë përveç sigurisë së vendit edhe për sigurinë rajonale. Duke vlerësuar që FSK-ja është e gatshme të kontribuojë në sfidat e sigurisë së vendit dhe më gjerë. Ndërsa sa i përket rishikimit të buxhetit dhe çështje së gradimeve, theksoi që për këtë çështje është krijuar bordi i gradimeve të cilët do të kryejnë detyrën e vet për të përcaktuar në pozita adekuate, të gjithë që tani janë si ushtrues detyre. Ndërsa sa i përket rishikimit të buxhetit, theksoi se janë bërë kërkesat nga ana e ministrisë dhe gjithashtu është bërë dëgjimi me Ministrin e Financave për vitin fiskal 2018, dhe nuk është ai buxhet që e pret ministria, pasi në bazë të Analizës së Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë, ishte paraparë që për çdo vit fiskal të rritet buxheti i Ministrisë së FSK-së për 5 000 000 (pesë milionë), por përgjigjja e Ministrisë së Financave ka qenë se tani për tani është ky buxhet, ndërsa në momentin e marrjes së vendimit politik për transformimin e FSK-së, do të aplikohet rritja e buxhetit. Ndërsa për vitin 2018 Ministria e FSK-

sa ka rritje të buxhetit prej 3 000 000 (tre milionë) ero, dhe në total; buxheti është 54 000 000 (pesëdhjetë e katër milionë) ero.

Ndërsa sa i përket pjesëmarrjes së minoriteteve në kuadër të FSK-së, theksoi se posedojnë listën e minoriteteve që janë pjesë e FSK-së, dhe është një numër i caktuar i komunitetit boshnjak dhe në ditët në vijim do të përcjellë këtë statistikë, duke shtuar se në tërësi minoritetet janë mbi 10%.

Bahrim Shabani kërkoi që të dhënat e tilla të dërgohen me emër dhe mbiemër, pasi disa janë deklaruar si boshnjakë, por që nuk janë boshnjakë.

Rrustem Berisha, ministër i Ministrisë së FSK-së, lidhur me këtë çështje theksoi se janë procedurat për pranim dhe dokumentin për dëshminë e nacionalitetit gjithsecili e merr në komunën e tij dhe është dokument zyrtar. Ndërsa në përgjigjeje të pyetjes së znj. Drita Millaku, theksoi se numri i pjesëtarëve të FSK-së aktualisht është 3 124, ndërsa 800 janë rezervë, por me transformimin e FSK-së numri do të rritet dhe procedura e rritjes së numrit është e paraparë me faza. Ndërsa sa i përket armatimit, theksoi se në bazë të misionit aktual që ka posedon edhe armatimin i cili është i lehtë. Gjithashtu theksoi që, në momentin e ndërrimit të misionit të FSK-së shteti do të ndërhyjë në rritjen e buxhetit.

Rexhep Selimi, kërkoi që të ketë një solidaritet me anëtarin e komisionit nga komuniteti boshnjak për çështjen e ngritur, pasi shpesh herë fokusimi bëhet vetëm në komunitetet e tjera, duke vlerësuar që kontributi i komunitetit boshnjak duhet vlerësuar si i gjithë komuniteteve të tjera, duke theksuar që nuk ka pasur të dhëna lidhur me shqetësimin e ngritur nga z. Shabani.

Rrustem Berisha, ministër i Ministrisë së FSK-së, theksoi se në takimin e radhës do të paraqes statistikën pasi në këtë takim nuk është i pajisur me to, ndërsa shtoi që gjithsecili nga deputetët është i mirëpritur që të paraqes shqetësimet e tyre në ministri.

Fadil Beka e përshëndeti ministrin dhe kërkoi që të dijë më shumë sa i përket komponentës së shëndetësisë. Pasi do të bëhet transformimi i FSK-së në Forcë të Armatosura. Si është menduar që të organizohet shëndetësia në kuadër të FSK-së në të ardhmen?

Rrustem Berisha, ministër i Ministrisë së FSK-së, lidhur me çështjen e ngritur nga z. Beka, theksoi se e dinë rëndësinë e kësaj çështjeje dhe i është kushtuar rëndësi, por është paraparë edhe për të ardhmen. Tutje theksoi që janë shërbime shëndetësore të nivelit jo spitalor brenda FSK-së, pasi në çdo vend ku ka kazerma, ka marrëveshje me spitalet e rajonit.

Xhelal Sveçla shtroi pyetjet: A është përmbushur maksimumi i armatimit që mund të ketë FSK-ja, për nga kalibri dhe lloji? A mundet të dërgohet plani i integritetit i ministrisë te komisioni?

Rrustem Berisha, ministër i Ministrisë së FSK-së, në përgjigjeje të pyetjeve të ngritura nga z. Sveçla, theksoi se mund të dërgohet plani i integritetit, i cili është realizuar me mbështetjen e Qeverisë Norvegjeze. Ndërsa sa i përket armatimit theksoi që për misionin aktual i ka të përmbushura të gjitha nevojat, ndërsa për misionin e ardhshëm është çështje tjetër dhe se janë të definuar në listën e planifikimeve. Duke shtuar që qëllimi është në ngritjen e kapaciteteve mbrojtëse dhe se nuk ka pretendimi territoriale ndaj askujt.

Fatmir Xhelili propozoi te ministri që për shkak të përbërjes së komisionit që janë për herë të parë në këtë komision, të mbahet ndonjë ligjëratë në kuadër të Ministrisë së FSK-së, lidhur me mbrojtjen e butë dhe mbrojtjen e hekurt, ku në këtë takim do të dilnin konstatimet për nevojat e armatimit dhe llojllojshmërinë, si dhe nevojat buxhetore për këtë. Duke shtuar që përcaktimi për mbrojtjen e butë është evidente për shtetin e Kosovës.

Rrustem Berisha, ministër i Ministrisë së FSK-së, lidhur me propozimin e z. Xhelili, thekso që Ministria e FSK-së, do të jetë e gatshme të ofrojë prezantime në fushat që shprehin interes deputetët.

Kryetari shtroi pyetjet për ministrin. Sa është i gatshëm Departamenti për përpilimin e dokumentacionit në kuadër të Ministrisë së FSK-së, për nxjerrjen e dokumentacionit sa i përket transformimit të misionit? A është duke bashkëpunuar me DIR në këtë drejtim? Duke filluar nga ndryshimet kushtetuese, ligjore dhe rregulloret e nevojshme.

Rrustem Berisha, ministër i Ministrisë së FSK-së, lidhur me çështjen e transformimit, theksoi që është formuar komisioni për këtë çështjen dhe është duke punuar në këtë drejtim, ku janë nxjerrë një sërë rregulloresh për përgatitjen e misionit të ardhshëm të FSK-së. Gjithashtu theksoi se do të ketë nevojë për trajnime shtesë për FSK-në pas ndërrimit të misionit nga ai aktual.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2017

Kryetari kërkoi të japin komente nëse kanë anëtarët e Komisionit lidhur me planin e punës.

Fatmir Xhelili propozoi që raportimi i ministrit të Punëve të Brendshme të bëhet në javën e tretë të muajit dhjetor, pasi deri atë kohë grumbullohen indikatorët për realizimin obligimeve për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit.

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së me vota unanime nxori këtë:

VENDIM

Miratohet plani i punës së Komisionit për vitin 2017 me propozimet e bëra.

5. Të ndryshme

Kryetari i njoftoi për tryezën e rrumbullakët që do të mbahet më 8 nëntor 2017, e organizuar nga DCAF me temë: Qeverisjen dhe Mbikëqyrjen e Sektorit të Sigurisë.

Luanda Domi, përfaqësuese e DCAF për Kosovë, njoftoi për përmbajtje e tryezës dhe për ekspertët që do të jenë të pranishëm.

Fatmir Xhelili propozoi që si temë në këtë tryezë të përfshihet edhe “ Roli i Parlamentit në mbikëqyrjen e masave për luftimin e Krimi i organizuar dhe Korrupsioni”.

Rexhep Selimi theksoi që nga ana e DCAF afrohen ekspertë ndërkombëtarë, dhe se tema të caktuara mund të diskutohen në tryezë edhe nëse nuk janë paraparë në agjendë, ose mund të kërkohen për tryezat e ardhshme. Gjithashtu propozoi që më 7 nëntor të mbahet një takim paraprak me përfaqësuesit e DCAF nga Gjeneva.

Kryetari propozoi që sipas planit të punës të planifikohet vizita e radhës në institucionet që mbikëqyr Komisioni.

PËRFUDNIM

Pas diskutimeve u dakordua vizita e radhës e Komisionit të bëhet në Inspektoratin Policor të Kosovës

Kryetari me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Haxhi Shala